

VENDIM
Nr.68, datë 11.2.2011

**MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE TË PARAQITURA NË
KËRKESËN PËR MARRJE LICENCE NGA PERSONI FIZIK Z.DRITAN MEMUSHI,
LICENCUAR PËR SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TEPELENA SAT”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22 dhe neni 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

Personi fizik z.Dritan Memushi, është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.428, datë 21.3.2006 të KKRT-së, për subjektin televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”, duke u autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për të penetruar në qytetin e Tepelenës. Me vendimin nr.512, datë 29.9.2006, KKRT-ja ka vendosur zgjerimin e zonës së licencimit të këtij subjekti në qytetin e Ersekës.

Personi fizik z.Ervid Likollari, është licencuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit me vendimin nr.18, datë 28.7.2010 të KKRT-së, për subjektin televiziv privat kabllor “Tv kabllor DCT”, duke u autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për të mbuluar me sinjal bashkinë Poliçan dhe komunën Ksamil.

Me shkresën e depozituar në KKRT në datën 1.12.2010, nga ana e subjektit televiziv privat kabllor “Tepelena Sat” është paraqitur në KKRT, kërkesa për miratimin e disa ndryshimeve të ndodhura në këtë subjekt televiziv. Subjekti njofton se nëpërmjet kontratës së shitjes, të datës 20 nëntor 2010, z.Ervid Likollari, licencuar nga ana e KKRT-së, për operatorin televiziv privat kabllor “Tv kabllor DCT”, i ka shitur aktivitetin e tij z.Dritan Memushi.

Sipas kontratës së shitjes depozituar, bashkëlidhur shkresës njoftuese, rezulton se:

“...shitësi pohon se ia shet blerësit kundrejt një çmimi prej 10 500 000 lekë...”

Si dhe,

“Që nga momenti, që palët kanë kryer realisht këtë veprim juridik, shitësi nuk ka më asnjë të drejtë mbi këtë licencë dhe aktivitetin e ushtruar prej saj dhe blerësi bëhet pronar me të drejta të plota dhe pa kushte mbi të gjithë këtë aktivitet televiziv të lartpërmendur. Të gjitha pasojat dhe detyrimet ligjore (taksa-tatime, sigurime shoqërore, energjinë elektrike, ujin e pijshëm, taksat e KKRT-së etj.) të këtij aktiviteti hyjnë në fuqi në momentin e marrjes në dorëzim të aktivitetit...”

Mbështetur në nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit: “Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta miratimi i

jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash”.

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar: “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës... dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve...”.

Nëpërmjet kontratës së shitjes së aktivitetit, subjekti i licencuar nga KKRT-ja “Tv kabllor DCT”, ka hequr dorë nga të drejtat që burojnë nga licenca e transmetimit, prandaj subjekti që i ka fituar ato, ka paraqitur kërkesë për miratimin e këtij ndryshimi, konform parashikimit ligjor.

KKRT-ja konstaton se subjekti që ka fituar të drejtat nëpërmjet kontratës së shitjes është një subjekt, i cili është i licencuar nga KKRT-ja, prandaj miratimi i kërkuar nga neni 22 i ligjit, nuk do të bëhet në formën e dhënies së një licence të re transmetimi, por përmes ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrje licence nga subjekti televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen të drejtë e të mbështetur, kërkesën e paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “Tv kabllor Tepelena Sat”,

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 22 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga personi privat fizik z.Dritan Memushi, licencuar për televizionin privat kabllor “Tepelena Sat”.

2. Kalimin e të drejtave të licencës nr.083/RTV kabllor, personit privat fizik z.Dritan Memushi, licencuar për televizionin privat kabllor “Tepelena Sat”.

3. Zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “Tepelena Sat”, në komunën Ksamil.

4. T’i heqë subjektit person privat fizik z.Ervid Likollari, licencën për televizionin privat kabllor “Tv kabllor DCT”.

5. Licenca nr.083/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.

6. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati